REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet publike, nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 4 pika 1 dhe nenit 5 të Rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit si dhe neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29.04.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE " ULPIANA" SH.A

Neni 1

Me këtë Vendim fillon procedurat për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" sh.a me seli në Lipjan.

Neni 2

N.P.L "Ulpiana" sh.a do të jetë shoqëri aksionare në pronësi të Komunës së Lipjanit dhe do të jetë kompetente për kryerjen e detyrave dhe punëve në vijim:

1.Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale,
2.Mirëmbajtjen e shesheve publike , parqeve varrezave të qytetit dhe varrezat e dëshmorëve, martirëve, lapidarëve,përmendoreve, pllakave përkujtimore të cilat menaxhohen nga komuna.
3.Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve publike të institucioneve të komunës.
4.Sigurimin fizik të objekteve të institucioneve të Komunës
5. Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendparkingjeve publike
6. Menaxhimin e shërbimit me auto merimangë
7.Mirëmbajtjen e tregut të gjelbër
8.Mirëmbajtjen e ndriçimit publik
9.Dekorimin e qytetit në ditët e festave
10.Mirëmbajtjen e oxhaqeve të ekonomive familjare dhe objekteve tjera
11.Mirëmbajtjen e kanalizimit atmosferik
12.Transportimin e kafshëve të ngordhura deri në lokacionin e destinuar për groposjen

e tyre

13. Mirëmbajtjen e objekteve banesore dhe ashensorëve

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Kryetari i Komunës autorizon zyrtarët përgjegjës komunal të cilët në bashkëpunim me drejtoratet kompetente komunale do të vazhdojnë procedurat për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm sipas kritereve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale"Ulpiana".

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme në vijim që kërkohen konform legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

15Nr. 15-352-21925

Lipjan, më 29.04.2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

REPUBLIKA E KOSOVO KOMUNA E LIPJANIT LIPJAN OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO